

VENDIM
Nr. 22, datë 18.1.2023

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 384, DATË
30.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FORMËN E KOMUNIKIMIT
NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 384, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët “... dhe konkurs projektimi ...” hiqen.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1.1., me këtë përmbajtje:

“1.1 Për procedurën e prokurimit “Konkurs projektimi”, fazat nga dorëzimi i kërkesave për shprehje interesi e në vijim zhvillohen në formë shkresore.”.

2. Ngarkohen të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku